



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA SHTIME

Zyra e Prokurimit

Nr. 03 / 1 / 007

Datë 16 / 04 / 2019

KONTRATA PUBLIKE KORNIZË 24 MUJORE

Komuna Shtime Rr., Tahir Sinani,, tel. 0290-389-016-/131 ose 045-444-509 të cilën e përfaqëson:
Drejtori i Prokurimit Muhamdin Halili në njëren anë ,

dhe

C.I.K. „ Caritas Kosova „, Rr., Rexhep Bislimi,, Ferizaj që e përfaqëson **Alfred Pjetri** Drejtor
ekzekutiv, nr i tel 044-783-857 , ne anën tjetër, janë pajtuar te lidhin një kontrate publike Kornizë 24
mujore për Shërbim

Numri i Prokurimit: **617- 19- 1034 - 221**

Numri i brendshëm i 617-2019-012-221

Titulli : Kujdesi shtepiak - paliativ i të sëmuarve në komunën e Shtimes

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës është përforcimi i shërbimeve në vijim nga ana e Ofruesit te Shërbimeve:

1.2

Qëllimi i këtij programi është të kontribuojë në përmirësimin e shëndetit dhe cilësisë së jetës të personave të moshuar, personave me aftësi të kufizuar pa përkujdesje familjare, dhe të gjithë tësëmurët tjere që për arsyet ndryshme nuk janë në gjendje të kujdesen për mirëqenien e tyre esidomos në mungesë të kujdesit familjar, duke ju ofruar shërbime bazë për lehtësimin e jetës sëtyre të përditshme dhe përmirësimin e mirëqenjes shëndetësore dhe sociale

Neni 2 Çmimi

2.1 Çmimi : **93,483.50 € për 12 muaj**

(Nëntëdhjetë e tremijë e katërqindë e tetëdhjetë e tri euro e pesëdhjetë centi) për 12 muaj +- 30%. Pasi që kontrata është korrizë për 24 muaj , vlera e kontratës për 24 muaj është e 186,967 euro me mundësi +- 30% .

2.1 Çmimi i përmendorur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Ofruesit te Shërbimeve sipas kontratës çmimi për njësi . Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtronhet ndryshimeve.

2.3 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

Neni 3 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Marrëveshja e kontratës;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Ofuesit te Shërbimeve, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknikë;
- (e) Oferta financiare (Përshkrimi i Çmimeve);
- (f) [shëno çdo dispozitë tjeter të dosjes së tenderit].

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 4 Komunikimet

4.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Ofuesit te Shërbimeve nga ana tjeter duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht.

4.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

4.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përvèç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkuar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" "do të interpretohen në përpjehje me rethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsy.

4.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën **shqip** në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Ofuesin e Shërbimeve.

Për Autoritetin Kontraktues

Për Ofuesin e Shërbimeve

Emri:	Muhadin Halili	Emri:	Alfred Pjetri
Pozita:	Drejtor i prokurimit	Pozita:	Drejtor ekzekutiv
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	16.04.2019	Data:	16.04.2019
Vula:		Vula:	

2
Ferizaj

PJESA II E KONTRATES

KUSHTET E PËRGJITHSHME

Neni 1 Përkufizimet

1.1 "Kontratë" do të thotë marrëveshje të lidhur ndërmjet Autoritetit kontraktues dhe Ofroesit të Shërbimeve, siç është shënuar në formularin e kontratës të nënshkruar nga palët, duke përfshirë të gjitha shtojcat për këtë dhe të gjitha dokumentet e inkorporuar me referencë në të.

1.2 "Shërbimet" do të thotë shërbimet qe do te ekzekutohen nga ana e Ofroesit e Shërbimeve në pajtim me Specifikimet dhe Përshtimin e Çmimit te përfshira në Tenderin e Ofroesit të Shërbimeve.

1.3 "Ofroes i shërbimeve" është Operatori Ekonomik ose grupi i Operatorëve Ekonomik, i caktuar në formularin e kontratës, që është palë në kontratë dhe i detyruar të krye detyrat në bazë të marrëveshjes, dhe që për detyrat e kryera do të marrë shumën e rënë dakord në formularin e kontratës.

1.4 "Personeli" do të thotë personat e angazhuar nga Ofroesi i Shërbimeve ose nga Nën-kontraktuesi si të punësuar dhe të caktuar për kryerjen e shërbimeve ose të ndonjë pjesë të tyre.

1.5 "Çmimi i kontratës" do të thotë shuma e deklaruar në Marrëveshjen që përfaqëson shumën totale të pagueshme për ofrimin e Shërbimeve.

1.6 "Nënkontraktuesi" do të thotë çdo person fizik, privat ose subjekt i qeverisë, ose kombinimi i tyre, duke përfshirë edhe pasardhësit e tij ligjor ose transferimet e lejuara, për të cilin çdo pjesë e Shërbimeve do të sigurohet ose ekzekutimi i ndonjë pjesë të Shërbimeve është nënkontraktuar nga Ofroesi i Shërbimeve.

1.7 "Palë" nënkupton Autoritetin Kontraktues ose Ofroesin i Shërbimeve, siç mund të jetë rasti, dhe "Palë" nënkupton të dy prej tyre.

1.8 "Autoriti Kontraktues" nënkupton autoritetin që blen Shërbimet, siç specifikohet në Kontratë.

1.9 "KPK" nënkupton Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.

1.10 "KVK" nënkupton Kushtet e Veçanta të Kontratës.

Neni 2 Ligji i aplikueshëm dhe gjuha

2.1 KVK e saktësojnë cili është ligji që i përcakton të gjitha çështjet që nuk janë të mbuluara në kontratë.

2.2 Kontrata dhe të gjitha komunikimet e shkruara ndërmjet palëve hartohen në gjuhën e specifikuar në KVK.

Neni 3 Transferimi

3.1 Transferimi do të jetë valid vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes të cilës Ofroesi i Shërbimeve e transferon kontratën e vet ose një pjesë të saj te një palë e tretë.

3.2 Ofroesi i Shërbimeve nuk mundet që, pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues, ta transferojë kontratën ose një pjesë të saj, ose ndonjë përfitim apo interes nga ajo, përvèc në këto raste:

a) kur ka ngarkesë për pagesë, në favor të bankierëve të Ofroesit të Shërbimeve, të shumave që duhet të paguhën ose që do të bëhen borxh sipas kontratës; ose

b) në rast të dhënes së të drejtës së Ofroesit të Shërbimeve siguruesve të Ofroesit të Shërbimeve për të kërkuar pagesën nga ndonjë person tjetër i detyruar në rastet kur siguruesit e kanë shkarkuar humbjen ose detyrimin e Ofroesit të Shërbimeve.

3.3 Për qëllimet e nenit 3.2, aprovimi i një transferimi nga Autoriteti kontraktues nuk do ta lirojë Ofroesin e Shërbimeve nga obligimet e veta për pjesën e kontratës që tashmë është realizuar ose për pjesën që nuk është bartur.

3.4 Pranuesit e dispozitave të kontratës duhet të plotësojnë kriteret e përshtatshmërisë që zbatohen për dhëni e kontratës përvèc në raste kur transferimi bëhet në bankë apo kompani të sigurimit ose institucion tjetër financiar.

Neni 4 Nën-kontraktimi

4.1 Nënkontrata është valide vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes së cilës Ofroesi i Shërbimeve ia beson realizimin e një pjesë të kontratës së tij një pale të tretë.

4.2 Ofrofuesi i Shërbimeve nuk nënkontraktion pa autorizim me shkrim nga Autoriteti kontraktues. Elementet e kontratës që do të nënkontraktohen dhe identiteti i nënkontraktuesve i bëhen të ditura Autoritetit kontraktues. Autoriteti kontraktues do ta lajmërojë Ofrofuesin e Shërbimeve për vendimin e vet brenda 30 ditë pune nga marrja e njofitimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

4.3 Autoriteti kontraktues nuk njeh lidhje kontrakte ndërmjet vetes dhe nënkontraktuesve.

4.4 Ofrofuesi i Shërbimeve është përgjegjës për aktet, gabimet dhe neglizhencën e nënkontraktuesve të vet si dhe të agjentëve ose të punësuarve, në të njëjtën mënyrë si po të ishin akte, gabime ose neglizhencë e Ofrofuesit të Shërbimeve, agjentëve të tij ose punëtorëve të tij. Aprovimi i nënkontraktimit të ndonjë pjese të kontratës ose aprovimi i nënkontraktuesit nga ana e Autoritetit kontraktues nuk e liron Ofrofuesin e Shërbimeve nga obligimet e tij sipas kontratës.

Neni 5 Tatimet dhe Doganat

5.1 Ofrofuesi i Shërbimeve është përgjegjës për të gjitha taksat dhe doganat në pajtim me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Ofrofuesi i Shërbimeve, Nënkontraktuesit, dhe Personeli i tyre do t'i paguaj ato taksa, dogana, tarifa dhe detyrime të tjera që mund të vendosen sipas ligjit në fuqi, shuma e të cilave mendohet të ketë qenë e përfshirë në çmimin e kontratës.

Neni 6 Fillimi dhe Përfundimi i shërbimeve

6.1 Kjo kontratë hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të kontratës nga të dy palët ose ne një date tjeterë të mëvonshme siç mund të ceket në KVK.

6.2 Para fillimit të Shërbimeve, Ofrofuesi i Shërbimeve do të dorëzoj Autoritetit Kontraktues për miratim një Program që tregon metodat, aranzhimet, rendin dhe kohën për të gjitha aktivitetet. Shërbimet do të kryhen në pajtim me programin e miratuar.

6.3 Ofrofuesi i Shërbimeve do të filloj shërbimet sa më shpejt që është arsyeshëm e mundur pas marrjes së urdhrit me ekspeditën e duhur dhe pa vonesë.

6.4 Ofrofuesi i Shërbimeve do të përfundoj aktivitetet në datën e planifikuar të përfundimit, siç është e specifikuar në KVK. Nëse Ofrofuesi i Shërbimeve nuk i përfundon aktivitetet në datën e planifikuar të përfundimit, ai do të jetë përgjegjës për të paguar démet e likuiduara. Në këtë rast, Data e Përfundimit do të jetë data e përfundimit të gjitha aktiviteteve.

6.5 Vend i kryerjes së shërbimeve është i përcaktuar në KVK.

6.6 Përveç njësive që të bëhet ndryshe, ekzekutimi i kontratës do të fillojë jo më vonë se 90 ditë pas njofitimit të dhënies së kontratës. Pas kësaj ofrofuesi i Shërbimeve do të ketë të drejtë të mos e ekzekutojë kontratën dhe ta marrë ndërprerjen e saj ose kompensimin për démin që i është shkaktuar. Ofrofuesit të Shërbimeve do t'i merret kjo e drejtë, përvëc njësive e ushtron brenda 30 ditësh pas skadimit të periudhës 90-ditore.

Neni 7 Zgjatja e periudhës së përfundimit

7.1 Ofrofuesi i Shërbimeve mund të kërkojë zgjatje të periudhës së ekzekutimit nëse realizimi i kontratës së tij vonohet, ose pritet se do të vonohet, për ndonjërin nga këto arsyet:

- Autoriteti kontraktues ka dështuar t'i plotësojë obligimet e veta sipas kontratës;
- forca madhore siç është e definuar në Nenin 8;

7.2 Brenda 15 ditëve me të kuptuar se një vonesë mund të ndodhë, Ofrofuesi i Shërbimeve do të njoftoj Autoritetin Kontraktues mbi qëllimin e tij që të bëj një kërkesë për zgjatjen e periudhës së realizimit për të cilën ai konsideron se ka të drejtë dhe, përvëse kur është rënë dakord ndryshtë ofrofuesit të shërbimeve dhe Autoritetit Kontraktues, brenda 30 ditëve nga e njëjta pikë në kohë të sigurojë Autoritetin Kontraktues me hollësi të plotë në mënyrë që të mund të shqyrtohet kërkesa.

7.3 Brenda 30 ditëve nga marrja e hollësive të përmendura në 7.2, Autoriteti Kontraktues me anë të njofitimit me shkrim do t'i lejoj Ofrofuesit të Shërbimeve zgjatjen e periudhës së ekzekutimit siç mund të arsyetohet, ose në mënyrë prospективë dhe retrospektive, ose të informoj Ofrofuesin e Shërbimeve që ai nuk ka të drejtë në zgjatje.

Neni 8 Forca madhore

8.1. Asnjëra palë nuk konsiderohet se ka bërë shkelje të obligimeve të saj sipas kontratës nëse realizimi i obligimeve të tilla parandalohet nga ndonjë ngjarje e shkaktuar nga një forcë *madhore* që shkaktohet pas datës së njoftimit mbi dhënie të kontratës ose kur kontrata hyn në fuqi.

8.2. Termi "forcë *madhore*" do të thotë veprimet e zotit, goditjet, mbylljet e objektit ose çregullimet tjera industriale, veprimet e armikut publik, luftërat qofshin të deklaruara ose jo, blokadat, rebelimet, rastet e dhunës, epidemite, rrëshqitjet e tokës, tërmetet, shtrëngatat, vëtëtimë, vërsimet, erozionet, trazirat civile, eksplodimet dhe ndonjë ngjarje tjeter e ngjashme e paparashikuar që është përtëj kontrollit të palëve dhe nuk mund të përballohet as me kujdesin e duhur.

8.3. Pala e ndikuar nga një ngjarje e forcës *madhore* do të marr të gjitha masat e arsyeshme për të mënjanuar paftësinë e një pale të tillë që të përbush detyrimet e saj tanë e tutje me një vonesë minimale.

8.4. Ofri i Shërbimeve nuk do të jetë përgjegjës për dëmet e likuiduara ose ndërprerje nëse vonesa e tij në realizimin ose dështimi për të realizuar obligimet e tij me kontratë është rezultat i një ngjarjeje të forcës *madhore*. Autoriteti Kontraktues nuk do të jetë i detyruar të paguajë interes për pagesat e vonuara, për mosrealizim ose për ndërprerje nëse vonesa e Autoritetit Kontraktues ose lloj jetë i dështimit për të kryer obligimet e tij është rezultat i forcës *madhore*.

8.5. Nëse ndonjëra palë konsideron se ndonjë rrethanë e forcës *madhore* ka ndodhur e cila mund të ndikojë në realizimin e obligimeve të saj, menjëherë do ta lajmërojë palen tjeter, duke dhënë të dhëna detaje mbi natyrën, kohëzgjatjen e mundshme dhe efektin që kanë gjasa ta kenë rrethanat. Përveç nëse udhëzohet ndryshe nga Menaxheri i Projektit me shkrim, Ofri i Shërbimeve do të vazhdojë t'i realizojë obligimet e tij sipas kontratës përdërsa është mjaft praktikë, dhe të angazhojë të gjitha mjetet e arsyeshme alternative për të plotësuar ndonjë obligim që ngjarja e forcës *madhore* të mos e pengojë atë gjatë punës. Ofri i Shërbimeve nuk do të zbatojë mjetet tilla alternative përvëc nëse udhëzohet ta bëjë këtë nga Menaxheri i Projektit.

Neni 9 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

9.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Ofri i Shërbimeve 14 ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet e mëposhtme:

- (a) Ofri i Shërbimeve dështon në përbushjen brenda një afati të arsyeshëm të paralajmërimit të dhënë nga autoriteti kontraktues që kérkon nga ai të evitojë ndonjë neglizhencë apo dështim për të realizuar obligimet e veta sipas kontratës, dhe të cilat ndikojnë në mënyrë serioze në realizimin e duhur dhe me kohë të shërbimeve;
- (b) Ofri i Shërbimeve refuzon ose është neglizhent në realizimin e urdhreve administrative të dhëna nga autoriteti kontraktues;
- (c) Ofri i Shërbimeve ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga Autoriteti kontraktues;
- (d) Ofri i Shërbimeve falimenton ose është duke u mbyllur; punët e tij janë duke u administruar nga gjykatat, ka hyrë në marrëveshje me kredituesit, ka pezulluar aktivitetet biznesore, i nënshtronhet procedurave ligjore lidhur me ato çështje, ose është në ndonjë situatë analogë që shkaktohet nga ndonjë procedurë e ngjashme e paraparë në legjislacionin apo në regjulloret nationale;
- (e) Ofri i Shërbimeve është dënuar për një shkelje që ka të bëjë me sjelljen profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res judicata*;
- (f) Ofri i Shërbimeve është shpallur fajtor për sjellje të rëndë të keqe jo profesionale të dëshmuar me çfarëdo mjeti të cilin mund ta vërtetoj Autoriteti kontraktues;
- (g) Ofri i Shërbimeve i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korruption, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale;
- (h) të gjitha modifikimet organizative që përfshijnë ndryshime në personalitetin ligjor, natyrën ose kontrollin e Ofrit i Shërbimeve, përvëc nëse këto modifikime regjistrohen në suplementin e kontratës;
- (i) shfaqet ndonjë paaftësi tjeter ligjore që i pengon realizimin të kontratës;

(j) Ofresi i Shërbimeve nuk arrin të japë garancinë ose sigurimin e kërkuar, ose nëse personi që e jep garancinë apo sigurimin më të hershmë të kërkuar në kontratën e tanishme nuk është në gjendje t'i plotësojë zotimet e tij.

9.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim ndaj të drejtave apo mundësive tjera të Autoritetit kontraktues dhe Ofresit të Shërbimeve sipas kontratës. Autoriteti kontraktues, pas kësaj mund të nënshkruajë ndonjë kontratë tjetër me një palë të tretë në emër të Ofresit të Shërbimeve.

9.3 Autoriteti Kontraktues, pas lëshimit të njoftimit të ndërprerjes së kontratës, do ta udhezojë Ofresin e Shërbimeve që të ndërmarrë hapë të menjëherë për la përmbyllur ekzekutimin e shërbimeve në mënyrë të shpejtë dhe të regullt dhe për t'i zgjeguar në minimum shpenzimet.

9.4 Në rast të ndërprerjes, autoriteti kontraktues, sa më shpejt që të jetë e mundur dhe në prani të Ofresit të Shërbimeve ose të përfaqësuesve të tij ose duke u bërë atyre thirrjen e duhur, do ta përgatisë një raport mbi shërbimet e kryera. Do të përgatitet edhe një deklaratë e parave që duhet t'i paguhen Ofresit të Shërbimeve dhe parave që i ka borxh Ofresi i Shërbimeve Autoritetit kontraktues në datën e ndërprerjes së kontratës.

9.5 Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i obliguar të bëjë pagesa tjera për Ofresin e Shërbimeve derisa të janë përfunduar shërbimet, ndërsa Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë të marrë nga Ofresi i Shërbimeve koston ekstra, nëse ka, për të siguruar ofresin e shërbimeve ose do të paguajë shumën që duhet t'i paguhet Ofresit të Shërbimeve para ndërprerjes së kontratës.

9.6 Nëse Autoriteti kontraktues e ndërpërt kontratën, ai do të ketë të drejtë të marrë nga Ofresi i Shërbimeve humbjet që i janë shkaktuar nën kushtet e kontratës.

Neni 10 Ndërprerja nga ana e Ofresit të Shërbimeve

10.1 Ofresi i Shërbimeve, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues;

- a. nuk arrin t'i paguajë Ofresit të Shërbimeve shumat që duhet të paguhen në ndonjë certifikatë të lëshuar nga personi i autorizuar pas skadimit të afatit të fundit;
- b. vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta edhe pas rikujitimeve të përsëritura; ose
- c. ose, si rezultat i Forcës Madhore, Ofresi i Shërbimeve është i paaftë të kryej një pjesë materiale të Shërbimeve për një periudhë prej jo më pak se gjashtëdhjetë (60) ditë.

10.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim për ndonjë të drejtë apo autoritet tjetër sipas kontratës së Autoritetit kontraktues dhe Ofresit të Shërbimeve.

10.3 Në rast të ndërprerjes sipas paragrafit (a) dhe (b) te Seksionit 10.1, Autoriteti kontraktues do ta paguajë Ofresin e Shërbimeve për humbje ose dëm që mund t'i jetë shkaktuar Ofresit të Shërbimeve.

Neni 11 Obligimet e Ofresit të Shërbimeve

11.1 Ofresi i Shërbimeve do të kryej Shërbimet sipas kontratës me kujdes, efikasitet dhe zell, në përputhje me praktikat më të mira profesionale.

11.2 Ofresi i Shërbimeve duhet të veprojë sipas urdhreve administrative që i jep autoriteti kontraktues. Nëse Ofresi i Shërbimeve konsideron se kërkesa e një urdhri administrativ shkon përtëj fushëveprimit të kontratës, ai, duke iu ekspozuar dënimit për shkelje të kontratës, do ta njoftojë autoritetin kontraktues për këtë duke i paraqitur arsyet e tij brenda 30 ditësh pas pranimit të urdhrit. Ekzekutimi i urdhrit administrativ nuk do të pezullohet për shkak të këtij njoftimi.

11.3 Ofresi i Shërbimeve duhet t'i respektojë dhe të veprojë sipas të gjitha ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Republikën e Kosovës dhe do të sigurojë që personeli i tij, të afërmët e tyre, dhe punëtorët vendorë të tij gjithashtu t'i respektojnë dhe të veprojnë sipas këtyre ligjeve dhe rregulloreve.

11.4 Ofresi i Shërbimeve duhet t'i trajtojë të gjitha dokumentet dhe informatat e marra lidhur me kontratën si private publikojë ose shpalosë asnjë detaj të kontratës pa pajtim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues.

11.5 Nëse Ofresi i Shërbimeve është konsorcium i dy ose më tepër personave, të gjithë personat e tillë do të janë bashkërisht dhe vazhdimisht të obliguar t'i plotësojnë kushtet e kontratës. Personi i caktuar nga konsorciumi që të

vaproj në emër të tij për qëllime të kësaj kontrate do të ketë autoritetin që të lidh konsorciumin. Përbërja e grupit nuk do të ndryshohet pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues.

11.6 Ofroesi i Shërbimeve do të punësoj personelin kyç të identifikuar në tender e tij për të kryer funksionet e përcaktuara në tenderin e tij. Për më tepër, gjatë ekzekutimit, dhe në bazë të kërkesës me shkrim dhe të arsyetur, autoriteti kontraktues mund të kërkojë për një zëvendësim nëse vlerëson se një anëtar i stafit është i paefektshëm, ose nuk kryen detyrat e tij sipas kontratës. Autoriteti kontraktues do të miratojë çdo zëvendësim të propozuar të personelit kryesor, vetëm nëse kualifikimet e tyre përkatëse dhe aftësitet janë thelbisish të barabarta ose më të mirë se ato të identikuara.

Neni 12 Obligimet e Autoriteti Kontraktues

12.1 Autoriteti kontraktues do t'i ofrojë ofroesit të shërbimeve menjëherë ndonjë informacion dhe/ose dokumentacion në dispozicion të tij, që mund të jetë relevante për zbatimin e kontratës. Dokumente të tilla do t'i kthehen Autoritetit Kontraktues në fund të periudhës së zbatimit të detyrave.

12.2 Autoriteti Kontraktues do të bashkëpunoj sa më shumë që është e mundur me Ofroesin e Shërbimeve për t'i siguruar informacione që ky i fundit mund t'i kérkoj në mënyrë të arsyeshme për kryerjen e kontratës.

12.3 Autoriteti Kontraktues do të caktoj "Menaxherin e Projektit", i cekur në KVK, i cili do të jetë përgjegjës për mbikëqyrjen e kryerjes së shërbimeve gjatë gjithë kohës dhe përaportimin e çdo hollësie Autoritetit Kontraktues.

Neni 13 Dëmet e likuiduara

13.1 Ofroesi i Shërbimeve do të pagua dëmet e likuiduara Autoritetit Kontraktues në normën ditore të cekur në KVK për çdo ditë që Data e Përfundimit është me vonë se Data e Kërkuar e Përfundimit. Shuma totale e dëmeve të likuiduara nuk duhet të tejkaloj shumën e përcaktuar në KVK. Autoriteti Kontraktues mund të zbras dëmet e likuiduara nga pagesat për shkak të Ofroesit të Shërbimeve. Pagesa e dëmeve të likuiduara nuk do të ndikoj në detyrimet e Ofroesit të Shërbimeve.

13.2 Nëse Data e përfundimit është zgjatur pasi që janë paguar dëmet e likuiduara, Autoriteti kontraktues do të përmirësojë çdo pagesë të tepër të dëmeve të likuiduara nga ofroesi i shërbimit, duke rregulluar certifikatën e ardhshme të pagesës.

Neni 14 Siguria e ekzekutimit

14.1 Ofroesi i Shërbimeve do të, jo më vonë se dita e nënshkrimit të kontratës, furnizoj Autoritetin Kontraktues me siguri për ekzekutim të plotë dhe të mire të kontratës. Shuma e sigurisë do të saktësohet në KVK. Siguria e ekzekutimit do të ndalet nga pagesa e Autoritetit Kontraktues përfarëdo humbjeje që është pasojë e mosekzekutimit të plotë dhe të duhar të obligimeve kontraktore nga ana e Ofroesit të Shërbimeve.

14.2 Siguria do të vazhdoj të jetë valide 30 ditë pas lëshimit të Certifikatës së Përfundimit.

14.3 Siguria e ekzekutimit të kontratës do të jetë në formën e dhënës në pjesën IV të kontratës.

Neni 15 Sigurimi që do të merret nga ofroesi i shërbimeve

15.1 Ofroesi i Shërbimeve do të marr dhe do të ruaj, dhe do të shkaktoj Nënkontraktorët të marrin dhe ruajnë, me shpenzimet e tyre, por në bazë të kushteve të miratuar nga Autoriteti Kontraktues, sigurimin nga rreziqet, dhe përmbulim, siç do të specifikohet në KVK.

15.2 Ofroesi i Shërbimeve, me kërkesë të Autoritetit Kontraktues, do të ofroj dëshmi për Autoritetin Kontraktues që sigurimi i tillë është marrë dhe ruajtur dhe se primet e tanishme janë paguar.

Neni 16 Parimet e përgjithshme të pagesës

16.1 Pagesat do të bëhen në Euro. Metoda dhe kushtet e pagesës që duhet t'i behet Ofroesit të Shërbimeve sipas kësaj Kontrate do te specifikohen ne KVK.

16.2 Pagesat që duhet te bëhen sipas faturës se lëshuar nga Ofroesi i Shërbimeve do të bëhen në llogarinë bankare të dhënë në Pjesën V, **Identifikimi Financiar**, i kësaj kontrate që e plotëson Ofroesi i Shërbimeve. I njëjtë

formular, që i bashkëngjitet kërkesës për pagesë, duhet të përdoret për t'i reportuar ndryshimet në llogarinë bankare.

16.3 Shumat duhet të paguhën brenda jo më shumë se 30 ditësh kalendare nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

16.4 Periudha prej 30-ditësh mund të pezullohet duke e lajmëruar Ofrcuesin e Shërbimeve që kërkesa për pagesë nuk mund të plotësohet sepse shuma nuk do të paguhet për shkak se nuk janë dorëzuar dokumentet e duhura përbajtjesore ose sepse ka dëshmi që shpenzimi mund të mos jetë legjitim. Në rastin e fundit mund të bëhet një inspeksi i menjëhershëm për qëllim të kontrollimeve tjera. Ofrcuesi i Shërbimeve do të japë sqarime, modifikime apo informata të tjera brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha e pagesës do të llogaritet nga data në të cilën është regjistruar kërkesa për pagesë e përgatitur në mënyrën e duhur.

16.5 Pasi që të ketë kaluar afati i fundit i dhënë në Nenin 16.3, Ofrcuesi i Shërbimeve mundet që, brenda dy muajsh pas pagesës së vonuar, të kërkojë interesin për pagesë të vonuar me normë të re-zbritje që zbatohet nga Banka Qendrore e Kosovës në ditën e parë të muajit në të cilin ka skaduar afati i fundit, plus shtatë pikë të përqindjes. Interes për pagesë të vonuar do të zbatohet për kohën që kalon ndërmjet datës së afatit të fundit të pagesës (nuk përfshihet) dhe datës në të cilën debitohet llogaria e Autoritetit kontraktues (përfshihet).

16.6 Të gjitha mos pagesat pas 90 ditësh nga skadimi i periudhës së dhënë në Nenin 16.3 do t'i jasin të drejtë Ofrcuesit të Shërbimeve që ose të mos e realizojë kontratën, ose ta ndërpresë atë, me paralajmërim prej 30 ditësh për Autoritetin kontraktues.

Neni 17 Kontrolli i kualitetit

17.1 Parimi dhe modalitetet e Inspektimit të Shërbimeve nga Autoriteti kontraktues do tëjenë si në KV.K. Autoriteti kontraktues do të kontrollojë punën e ofrcuesit të shërbimeve dhe të njoftojë atë për çdo defekt që është gjetur. Kontrolli i tillë nuk do të ndikojë në përgjegjësitë e ofrcuesit të shërbimeve. Autoriteti Kontraktues mund të udhëzojë ofrcuesit e shërbimeve të kërkojnë një defekt dhe të zbulojnë dhe provojnë çdo shërbim që Autoriteti Kontraktues konsideron se mund të ketë një defekt. Periudha garantuese e defekteve është si në KV.K.

Neni 18 Korrigimi i defekteve

18.1 Autoriteti kontraktues do të njoftojë ofrcuesit e shërbimeve për çdo Defekt para përfundimit të kontratës. Periudha garantuese e defekteve do të zgjatet për aq kohë sa Defektet të korrigohen.

18.2 Sa herë njoftimi për një defekt është dhënë, ofrcuesi i shërbimeve duhet të përmirësoj defektin e njofuar brenda kohës së specifikuar në njoftimin e Autoritetit Kontraktues.

18.3 Nëse ofrcuesi i shërbimeve nuk e ka korriguar defektin brenda kohës së specifikuar në njoftimin e Autoritetit Kontraktues, Autoriteti Kontraktues do të vlerësoj koston e korrigimit të defektit, ofrcuesi i shërbimeve do të paguaj këtë shumë, dhe do pasoj një dënim përmesë Ekzekutimi që llogaritet siç përshkruhet në nenin 13.1.

Neni 19 Konsekuençat e Shkeljes se kontratës

19.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë siç është cekur ne Nenin 9 dhe 10.

19.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/ose
- b) ndërprerjen e kontratës.

19.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të janë:

- a) Dëme të përgjithshme; ose
- b) Dëme të likuidueshme.

19.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhën Ofrcuesit të Shërbimeve, nga depozita, ose me pagesë nga siguria.

Neni 20 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

20.1 Palët duhet t'i bëjnë të gjitha përpjekje për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për qëndrimit e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkessës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkessës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

20.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpilen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KV. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 21 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

21.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) vendim nga gjyqi;

21.2 Para nënshkrimit te kontratës palët duhet te vendosin për mënyrën e zgjidhjes se mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

Neni 22 Dëmshpërbimi

22.1 Ofroesi i shërbimeve do te mbroje dhe do te dëmshpërbilej Autoritetin Kontraktues, zyrtaret e tij dhe ish zyrtaret, drejtoret, punonjësit dhe agjentet e tij dhe do te jete përgjegjës për te gjitha shpenzimet, humbjet, demet, dhe pagesat e shkakuara nga Autoriteti Kontraktues, duke përfshire por jo kuifizuar shpenzimet e tarifës se avokateve dhe shpenzimet ne lidhje me: neglizhencën ose keqpërdorimet e qëllimshme nga ana e ofroesit të shërbimeve, shkeljet apo shkeljet e pretenduar nga prezantimet e Ofroesit te Shërbimeve, pretendimet nga një palë e tretë se sigurimi i atyre shërbimeve nga ofroesi i shërbimit apo shfrytëzimi i tyre nga apo në emër të Autoritetit Kontraktues apo përdorimi ose sigurimi i ndonjë aseti te siguruar nga ofroesi i shërbimeve në lidhje me kryerjen e shërbimeve shkel të drejtat e pronësisë intelektuale të asaj pale të tretë.

PJESA III E KONTRATES KUSHTET E VEÇANTA

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizoterojnë mbi ato të KPK.

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet / Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Nr. Nenit	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksiioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë Gjuha Shqipe
Fillimi dhe Përfundimi i shërbimeve	6.1	Data e Fillimit të fillimit të Shërbimeve është 20.04.2019
	6.4	Data e Përfundimit është 20.04.2021
	6.5	Vendi i kryerjes së shërbimeve është Komuna e Shtimes me të gjitha fshatrat
Obligimet e Autoritetit Kontraktues	12.3	Menaxheri i projektit është : Behxhet Hyseni
Dëmet e likuiduara	13.1	Norma e dëmeve të likuiduara është 0.25 % e çmimit për njësi në ditë. Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për tërë kontraten është 10 % të çmimit final të kontratës.
Siguria e ekzekutimit	14.1	Shume e Sigurisë së Ekzekutimit është 10 % e vleres se kontratës, valide per 25 muaj nga data e nënëshkrimit të Kontratës
Sigurimi që do të merret nga ofruesi i shërbimeve	15.1	Rreziqet dhe mbulimi nga sigurimi do të jenë: a) Automjeti motorik i Palës së Tretë OE b) Përgjegjësia e Palës së Tretë OE c) Përgjegjësia ndaj punëdhënësit dhe kompensimi i punëtorëve OE d) Përgjegjësia profesionale Bie mbi OE e) Humbja ose dëmtimi i pajisjeve dhe pronës Bie mbi OE
Parimet e përgjithshme të pagesës	16.1	Orari i pagesës do të jetë: Pagesat OE do ti bëhen në baza mujore për shërbimet e kryera të dëshmuar me raport të menaxherit të projektit , për shërbimin e kryer në bazë të kontratës.
Kontrolli i kualitetit	17.1	Parimi dhe modalitetet e inspektimit te shërbimeve nga autoriteti kontraktues do te jene ne vijim: Menaxheri i projektit do të inspektoj shërbimet
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	20.2	Për çdo mosëmarrveshje eventuale në mes AK dhe OE do të zgjidhen me marrveshje
Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore	21.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet gjykatën kompetente] në pajtim me ligjin në Kosovë.

QKMF-ja Shtime
Specifikacion: Kujdesi shtëpiak-paliativ i të
sëmuarëve në Komunën e Shtimës

Nr.	Përshkrimi	Njësia matëse	Sasia	Çmimi në €	Shuma në €
1	<p>Shërbimet e kujdesit shëndetësorë shtëpiak të ofruara nga mjeku i përgjithshëm, si vizitë mjekësore për të moshuarit dhe kujdes palliativ, do të përfshijnë:</p> <p>Marrja e anamnezës, shikimi i dokumentacionit mjekësor ekzistues të pacientit, ekzaminimi i pacientit, matja e tensionit arterial dhe parametrave të tjere vital, përcaktimi i diagnozës, vendosja e menaxhimit të terapisë, vendosja e planit të mjekimit, përcjelja e gjendjes shëndetësore të pacientit dhe sipas nevojës udhëzimi përkujdes në nivelin dytësorë dhe tretësorë</p>	vizitë	1200	8.40	10,080.00
2	<p>Shërbimet e kujdesit shëndetësorë ambulantor të ofruara nga mjeku i përgjithshëm brenda institucionit të QKMF së apo QMF së në zonat rurale, si vizitë mjekësore, ku do të përfshijnë: Vizitë urgjente mjekësore, kontroll mjekësore, vizitë sistematike,,marrja e anamnezës, shikimi i dokumentacionit mjekësorë ekzistues të pacientit, ekzaminimi i pacientit, matja e tensionit arterial dhe parametrave të tjere vital, përcaktim i i diagnozës, vendosja e menaxhimit të terapisë,interpretimi i rezultateve dhe testeve të shpejtë laboratorike, monitorimin e gjendjes shëndetësore të pacientit, dhe si pas nevojës udhëzimi përkujdes në nivelin dytësorë dhe tretësorë institucional.</p>	vizitë	4000	4.00	16,000.00
3	<p>Shërbimet infermierore të kujdesit shëndetësorë shtëpiak për kujdes palliativ do të përfshijnë: Përgaditja e pacientit përvizitë mjekësore, matja e shenjave vitale, aplikimi i terapisë orale,dhe parenterale, Përpunimi ,pastrimi dhe lidhja (fashimi) e plagëve dekubitare dhe illojeve tjera, vendosja dhe ndërrimi i kateterëve urinar, këshillime, edukimi shëndetësor, ushtrimet pasive dhe aktive si preventivë përddekubitare, dokumentimi.</p>	shërbim	2500	5.30	13,250.00

A.P.

4	Shërbimet infermierore të kujdesit shëndetësorë ambulantor do të përfshijnë: Pranimin dhe sistemin e pacientit përvizitë mjekësore, aplikimi i terapisë orale,dhe parenterale (injeksioneve ,infuzioneve , Përpunimi ,pastrimi dhe lidhja (fashimi) e plagëve, Vendosja dhe ndërimi i kateterëve urinar,këshillime, edukim shëndetësor, etj	shërbim	4000	2.50	10,000.00
5	Shërbime të kujdesit oral ambulantor (stomatologjik) përfituesit e këtyre shërbimeve me probleme të ndryshme sociale dhe shëndetësore.	vizitë	2000	5.70	11,400.00
6	Shërbime shtëpiake dhe ambulantore diagnostike laboratorike do të përfshijnë: Marrja e gjakut përvizitë,ruajtja dhe transporti deri në laborator, përpunimi i tyre dhe dorëzimi i rezultateve, përvizat në gjendje të rëndë sipas kërkesës dhe udhëzimit të mjekut.Marrja e gjakut, përpunimi laboratorik dhe dorëzimi i rezultatetave të analizave përvizat në gjendje të rëndë sipas kërkesës dhe udhëzimit të mjekut.Marrja e gjakut, përpunimi laboratorik dhe dorëzimi i rezultatetave të analizave përvizat në gjendje të rëndë sipas kërkesës dhe udhëzimit të mjekut.Dokumentimi .	shërbim	1000	3.00	3,000.00
Gjithsejt:					63,730.00€

Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenje Sociale
Shtëpia e Komunitetit –Shtime

Specifikacion :Kujdesi shtëpiak palliativ – Shtëpia e Komunitetit

Nr.	Pershkrimi	Njesi	Sasia	Çmimi për person në Euro	Shuma në Euro
1	Aktivitetet rekreative sociale dhe rehabilitimi në banjë përklientet rezident në Shtëpinë e komunitetit në Shtime kanë përqellim : <p>1.Socializimin e këtyre klientëve , zhvillimin e autonomisë së individëve dhe pjesëmarrje në jetën sociale dhe atë të komunitetit në përgjithësi përmes kontaktit të drejtëpërdrejtë me shoqérinë .</p> <p>2. Të kontribuojë në përmirsimin e shëndetit ,rritjes së cilësisë së jetës dhe rehabilitimit fizik të klienteve.</p> <p>Pershkrimi i Projektit dhe kerkesat:</p> <p>1. Numri i pjesëmarrësve në këtë aktivitet ----- 18 persona (11 kliente dhe 7 puntorë si kujdestarë)</p> <p>2. Vend i qëndrimit -- Qendra rehabilituese dhe fizikale Kllokot - Kosovë</p> <p>3. Koha e qëndrimit -- 6 hetë e 7 ditë</p> <p>4. Transporti në relaciuni Shtime - banjë dhe anasjelltas</p> <p>5.Akomodimi në Banjë me pansion të plotë :</p> <p>6.Menza e Ushqimit në tri racione me përbajtje të ushqimit cilësor e kalorik. Mëngjesi : sup, qaj, qumësh, vezë, salqiqe,gjalp të ndryshem ose ekuivalent.Dreka : Gjella të ndryshme kalorike,sallata të ndryshme,ëmbelsirë,pije te gazaura, lëngje dhe ujë. Darka : File pule , pleskavice, peshk,patate të fërguara.</p> <p>7.Koha e Implementimi sipas kerkeses së Shtëpisë së Komunitetit</p>	Akomodim	18	138.00	2,484.00

2	<p>Aktivitetet rekreative sociale dhe rehabilitimi në Prevallë për klientet rezident në Shtëpinë e komunitetit në Shtime kanë për qellim :</p> <p>1.Socializimin e këtyre klientëve , zhvillimin e autonomisë së individeve dhe pjesëmarrje në jetën sociale dhe atë të komunitetit në përgjithësi përmes kontaktit të drejtëpërdrejtë me shoqërinë .</p> <p>2. Të kontribuojë në përmirsimin e shëndetit ,rritjes së cilësisë së jetës dhe rehabilitimit fizik të klienteve.</p> <p>Përvetim i Projektit dhe kerkesat:</p> <p>1. Numri i pjesëmarrësve në këtë aktivitet ----- 20 persona (11 klientë dhe 9 punitore si kujdestarë)</p> <p>2. Vendi i qëndrimit -- Qendra Rekreative Prevallë - Kosovë</p> <p>3. Koha e qëndrimit – 7 netë e 8 ditë</p> <p>4. Transporti në relacioni Shtime - Prevallë</p> <p>5.Akomodimi në hotel me pansion të plotë :</p> <p>6.Manya e Ushqimit në tri racione me përbajtje të ushqimit cilësor e kalorik. Mëngjesi : sup, qaj, qumësh, vezë, salqiqe,gjalp të ndryshem ose ekivalente.Dreka : Gjella të ndryshme kalorike,sallata të ndryshme,ëmbelsirë,pije te gazaura, lëngje dhe ujë. Darka : File pule , pleskavice, peshk,patate të fërguara.</p> <p>7.Koha e Implementimit sipas kerkeses së Shtëpisë së Komunitetit</p>	Akomodim	20	140.00	2,800.00
3	<p>Shërbimet sociale përmes mbajtjen e higjienës në ambientin e mbrendshëm të shtëpisë për personat e moshuar dhe të pa aftë pa përkujdjes familiare.</p> <p>Këto shërbime përfshijnë:</p> <p>-Përmirësimin e kushteve jetësore në një mëjdis të sigurt dhe të rehatshëm, duke ndihmuar përfituesin e shërbimit në mbajtjen e higjenes së ambientit të mbrendshëm të shtëpisë duke bërë pastrimin e gjithë hapsirave të shtëpisë : Dyshemësë në dhoma,banjo , koridor etj .</p> <p>Pastrimin e dyverje dhe dritareve .</p> <p>Mbajtja e higjienës së ulëseve ,shtratit dhe tepihëve.</p> <p>Këtu përfshihen edhe paisje dhe materialet higjienike përmes pastrim.</p>	Shërbim	720	20.00	14,400.00

4	<p>Shërbime për asistencë sociale në komunitet për personat në nevojë për shërbime sociale.</p> <p>Këto shërbime përfshijnë asistimin e punëtorit social të QPS së gjatë ofrimit të këtyre shërbimeve :</p> <ul style="list-style-type: none"> -Këshilla për rastet delikuent – të mitur në konflikt me Ligjin -Sanim I marrëdhëneve bashkëshortore -Fëmijët e braktisur . -Fëmijët e prindërve me problem e bashkëshortore në proces të ndarjes . -viktimat e dhunës . - Fëmijët në kujdestari . -Personat e rritur viktima të dhunës në Familje . -Personat e moshuar pa kujdes familjar . <p>Si dhe shërbime tjera sipas nevojës.</p>	Shërbim	460	4.50	2,070.00
5	<p>Shërbime për asistencë psiko sociale edhe juridike në Qendren për Punë Sociale (QPS) dhe Shtëpinë e Komunitetit për Persona me Aftësi të Kufizuar Mendore në Shtime për personat në nevojë për shërbime sociale.</p> <p>Këto shërbime përfshijnë asistimin e punëtorit social të QPS së gjatë ofrimit të këtyre shërbimeve :</p> <ul style="list-style-type: none"> -Këshilla për rastet delikuent – të mitur në konflikt me Ligjin -Sanim I marrëdhëneve bashkëshortore -Fëmijët e braktisur . -Fëmijët e prindërve me problem e bashkëshortore në proces të ndarjes . -viktimat e dhunës . - fëmijët në kujdestari . -Personat e rritur viktima të dhunes në Familje . -Personat e moshuar pa kujdes familjar . <p>Si dhe shërbime tjera sipas nevojës.</p>	Shërbim	800	6.00	4,800.00
6	<p>Shërbime për asistencë në Skemën e Ndihmave Sociale .</p> <p>Këto shërbime përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> -Asistencë në teren gjatë verifikimit të rasteve sociale -Asistim në shpërndarjen e pakove ushqimore dhe veshmbathje . -Asistim gjatë verifikimit të riaplikimit të shfrytëzuesve të SNS -Asistim në vizitat e shfrytëzuesëve të SNS . 	Shërbim	1185	2.70	3,199.50
		Gjithë sej			29,753.50 €

REKAPITULIM		
Nr	Pozicioni	Çmimi në €
1.	Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare OKMF-ja	63,730.00 €
2.	Shtëpia e Komunitetit	29,753.50 €
GJITHSEJT TOTALI		93,483.50 €

EMRI I KOMPANIËS	C.I.K – CARITAS KOSOVA
ADRESA E PLOTE	R.R. NENE TEREZA NR 3 FERIZAJ
PËRFAQËSUAR NGA:	
EMRI & MBIEMRI	ALFRED PJETRI
POZITA	DREJTOR ENZEKUTIV
NËNSHKRIMI	
DATA	03/04/2019
VULA	



0014231

NUMRI I POLICËS	014231
SIGURUESI	K.S. SCARDIAN J.S.C Adresa: Rr. Perandori Justinian 3, 10000 Pristinë, Kosovo
AGJENTI	Ilirim Shaqiri Adresa: Rr. "Ahmet Kaçiku
I SIGUARI	KOSOVAR CATHOLIC CHURCH CARITAS Adresa: KISHA KATOLIKE REXHEP BISLIMI
NUMRI I BIZNESIT	5200022-0
NUMRI FISKAL	600246765
QËLLIMI I SIGURIMIT	Garanci e Kontratës
PËRFITUESI	KOMUNA SHTIME
TITULLI I KONTRATËS	KUJDESI SHTEPIAK PALIATIV I TE SEMUARVE NE KOMUNEN E SHTIMES
NUMRI I IDENTIFIKIMIT-PROKURIMIT	617-19-1034-2-2-1
TERRITORI I MBULIMIT	Republika e Kosovës
PERIUDHA E SIGURIMIT	761 ditë
SHUMA E SIGUARAR	18696.7 EURO
Nga:	16-04-2019 00:00:00
Deri:	16-05-2021 23:59:59
PRIMI I SIGURIMIT	411.33
TVSH 18 %	0.00
PRIMI +TVSH 18%	411.33
DATA E LËSHIMIT	2019-04-16 15:53:17

VËREJTJE: 617-2019-012-221

Police e sigurimit të Garancive është krijuar në bazë të Ligjit Mbi Marrëdhjetën e Detyrimeve Nr.04/L-077, i cili miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës me datë 10.05.2012, gjithashtu sipas Rregullave dhe Rregulloreve të Aprovura nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës. Pjesë përbërëse e kësaj police janë Kushjet e përgjithshme, pyetësori i plotësuar dhe të nënshkruar dhe çfarëdo dokumenti jetët i bashkangjitur me polici e sigurimit.

Kjo polici e sigurimit vërtetëson lëdhen e kontratës, dëshohet nga Siguruesi në bazë të deklarimeve dhe kërkuesave të bëra nga i Siguruar/përfaqësuesi i të siguruarit, i cili është përgjegjës i lidhur me saktësinë dhe vërtetësinë e deklarimeve të bëra prej tij.

Unë i Siguruar/përfaqësuesi i të siguruarit, deklaroj se i kam lexuar me vëmendje dhe i kam kuptuar kushjet e kontratës së sigurimit, deklaroj se do të dhahem me to, si dhe me të dhënat e përcaktuara e kësaj police sigurimi, dhe po nënshkruj konform vullnetit tim të lirë, e të plotë.

I SIGUARUARI CARITAS KOSOVAPol. Boftiq Bajrolli

(emri, mbiemri, nënshkrimi)



(emri, mbiemri, nënshkrimi)